



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Per dhënie titulli “Emblema e Artë e Qytetit”, Zj. Gianna Pierdomenico

Nr. 45 Datë 06.05.2010

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatorët “Per dhënie titulli “Emblema e Artë e Qytetit, Zj. Gianna Pierdomenico” me motivacionin:

“Për kontributin e saj në forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit Shqipëri – Itali, nëpërmjet përcjelljes të vlerave më të mira të gjuhës, kulturës, historisë dhe traditës italiane në qytetin e Korçës”

Në zbatim të ligjit 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32, pika “m” si dhe në VKB Nr.154 datë 22.12.2008, mbështetur në kompetencat që ai ka dhe mbas diskutimit të anëtarëve vendosi:

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e titullit “Emblema e Artë e Qytetit” Zj. Gianna Pierdomenico me motivacionin:
2. “Për kontributin e saj në forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit Shqipëri – Itali, nëpërmjet përcjelljes të vlerave më të mira të gjuhës, kulturës, historisë dhe traditës italiane në qytetin e Korçës”
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatorët dhe Drejtoria Juridike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Kryetari

Gjergji PENDAVINJI